



AVOKATI I POPULLIT I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS



AVOKATI I POPULLIT

Pietro Spera (Itali)

Z. Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës në maj 2018. Që prej vitit 2010 punon si gjykatës në Gjykatën e Gjenovës ku kryeson gjykime dhe procese ndërmjetësimi e pajtimi. Si ish-gjykatës ndërkombëtar në Dhomat për Krime Luftë dhe Krimin e Organizuar të Gjykatës Shtetërore të Bosnjë-Hercegovinës (Sarajevë), Avokati i Popullit Spera ka përvojë të gjerë ndërkombëtare. Më herët ai kryesoi Projektin Italian për Drejtësi në Afganistan (Kabul), ku zbatoi projekte për reforma në sistemin e drejtësisë për avancimin dhe garantimin e pajtueshmërisë me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Avokati i Popullit Spera ka botuar punime me tema të ndryshme, ndër të cilat administrimi i lëndëve gjyqësore dhe efikasiteti gjyqësor. Ai është anëtar i Listës së Ekspertëve për Monitorimin e Sanksioneve të Kombeve të Bashkuara si dhe ekspert në projektin e BE-së me titull "Fuqizimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë".

ÇFARË BËN AVOKATI I POPULLIT?

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) kanë detyrimin të mbrojnë të drejtat themelore të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës dhe të veprojnë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ndonëse është pjesë e Zyrës Administrative, Avokati i Popullit vepron në mënyrë të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Avokati i Popullit ka përgjegjësi ekskluzive për të dy institucionet (Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar).

Avokati i Popullit nuk ndërhyr në çështje gjyqësore ose procedura të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, përveçse në raste voneshash të paarsyeshme, por ai mund të nxjerrë rekomandime në fushën e tij të veprimtarisë dhe mund t'i referojë ligje Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

KORNIZA LIGJORE

Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit përshkruhen hollësisht në amendamentin kushtetues nr. 24, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, në rregullën 28 dhe rregullën 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës, dhe në rregullën 26 të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Çfarë e dallon krijimin e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar është se kjo zyrë ofron mbrojtje shtesë të të drejtave të njeriut për personat që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

KONTAKTI

Zyrën e Avokatit të Popullit mund ta kontaktoni në: ombudsperson@scp-ks.org, vizitoni www.scp-ks.org, ose me letërnë adresën postare:

Office of the Ombudsperson, Kosovo Specialist Chambers
 P.O. Box 47
 2501 CA, The Hague, The Netherlands



FUNKSIONET

Ndër të tjera, Avokati i Popullit mund:

- të marrë ankesa nga persona që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, të cilët pretendojnë shkelje të të drejtave të njeriut;
- të kryejë hetime lidhur me ankesa të pranueshme
- të shkojë dhe inspektojë objektet e paraburgimit;
- të propozojë ose mundësojë ndërmjetësim dhe pajtim, kur është e përshtatshme;
- t'u paraqesë rekomandime dhe propozojë zgjidhje Kryetarit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar për çështje që janë pjesë e funksioneve të tyre;
- t'i bëjë referime Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese;
- të marrë pjesë si amicus curiae (mik i gjykatës), me ftesë prej një gjykatësi të vetëm apo një paneli.

KONFIDENCIALITETI

Në kryerjen e funksioneve të veta, Zyra e Avokatit të Popullit u përmbahet standardeve më të larta të konfidencialitetit dhe në mënyrë të zellshme respekton praktikën dhe procedurat e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Zyra e Avokatit të Popullit garanton mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial që merr apo në të cilin ka qasje.

ANKESAT

Ndër funksionet e Avokatit të Popullit përfshihet kompetenca për kryerjen e hetimeve në lidhje me ankesat e parashtuara. Për këtë qëllim, Avokati i Popullit ka nxjerrë **Procedurën e Ankesave**, e cila përcakton hapat dhe procedurat e ndryshme të zbatueshme. Gjithashtu, **Formulari i Ankesës** i përpiluar prej Avokatit të Popullit, është dokumenti që duhet plotësuar nga personat që dëshirojnë të bëjnë ankesë, ku paraqesin pretendime për shkelje të të drejtave të tyre themelore nga ana e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni Udhëzuesin për Procedurën e Ankesave dhe Procedurën e Ankesave që gjenden në faqen e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Internet.

KODI I ETIKËS I AVOKATIT TË POPULLIT

Avokati i Popullit ka miratuar dhe publikuar **Kodin e Etikës për Avokatin e Popullit** që rregullon standardet profesionale të zbatueshme në punën e Zyrës së tij.

Avokati i Popullit duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe profesional në kryerjen e detyrave të tij dhe të veprojë në përputhje me normat e karakterit të lartë moral parashtuar në Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

SI TË PARAQITET ANKESË

*Për informacion të plotë në lidhje me paraqitjen e ankesës, ju lutemi shikoni **Formularin e Ankesës, Procedurën e Ankesave dhe Udhëzuesin për Procedurën e Ankesave** në: www.scp-ks.org.*